



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS AVOKATI I POPULLIT

**lidhur me**  
**vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren**

**Për:**

- Z. Abelard Tahiri, Ministër**  
**Ministria e Drejtësisë**
- Z. Uran Ismaili, Ministër**  
**Ministria e Shëndetësisë**
- Z. Milazim Gjocaj,**  
**Drejtor i Departamentit të Shëndetësisë në Burgje**
- Z. Sokol Zogaj, u.d. Drejtor i Përgjithshëm**  
**Shërbimi Korrektues i Kosovës**
- Z. Hamit Ademaj, Drejtor**  
**Qendra e Paraburgimit në Prizren**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit për Avokatit të Popullit, nr.05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Prizren

Prishtinë, më 25 janar 2018

## Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

1. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 31 tetor 2017 ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Prizren (në tekstin e mëtejshëm “QPP”). Grupi monitorues përbëhej nga dy juristë, një mjek dhe një psikologe.

## Historik i shkurtër i institucionit

2. Ndërtesa e QPP është ndërtuar në vitin 1964, fillimisht ka funksionuar nën administrimin e UNMIK-ut, deri në shkurt të vitit 2005 ku kompetencat e plotë të menaxhimit i ka marrë stafi vendor. QPP është e dedikuar për të paraburgosurit e regjioneve të afërta me Prizrenin, si dhe pranon personat për vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Gjykata Themelore deri në tre muaj. Ky Institucion ka kapacitetin prej 92 të burgosur, ka gjithsej katër krah, në tre krahë janë të vendosur të paraburgosurit dhe në një krah janë të vendosur të dënuarit me dënime të shkurtra.<sup>1</sup>

## Përshkrimi i përgjithshëm i institucionit

3. Të burgosurit janë të vendosur në krahët A, B, C, D. Kapaciteti i përgjithshëm është për 92 persona. **Në kohën kur MKPT e vizitoi këtë qendër ishin të vendosur 100 të burgosur, prej tyre 22 të dënuar.** Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e ka vizituar QPP në vitin në vitin 2010.<sup>2</sup>
4. Gjatë vizitës në QPP, ekipi monitorues u njoftua se planifikohet ndërtimi i një qendre të re të paraburgimit në Prizren, por procedurat kanë stagnuar dhe ende nuk është shënuar progres në këtë drejtim.

## Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

5. Gjatë vizitës së MKPT-së në QPP, personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e QPP. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

## Keqtrajtimi fizik

6. **MKPT gjatë vizitave në QPP ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.**

## Kushtet materiale

### Kushtet e akomodimit

7. Kapaciteti zyrtar i QPP-së është 92. Gjatë vizitës në qelitë e QPP-së, MKPT ka vërejtur se aktualisht numri i të burgosurve kishte arritur në 100 persona. MKPT ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar nëse hapësira e akomodimit nuk është në pajtim me

<sup>1</sup> Të dhëna nga ueb faqja e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në: <http://shkk.rks-gov.net> (31.10.2017)

<sup>2</sup> Shih: <https://rm.coe.int/16806972c7> (14.11.2017)

standardet e përcaktuar nga Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.<sup>3</sup> Bazuar në këtë standard hapësira për të paraburgosurit apo të dënuarit në qeli duhet të jetë së paku 4m<sup>2</sup> për person në një hapësirë ku akomodohen më shumë se një person, pa përfshirë aneksin e tualeteve.

8. Po ashtu, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parasheh që secili i burgosur duhet të ketë 4m<sup>2</sup> hapësirë në qeli të përbashkët.<sup>4</sup> Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se në disa qeli për shkak të mungesës së hapësirës, disa të paraburgosur dhe të dënuar flinin në dysheme në dyshek të vjetruar dhe pa mbulesa adekuate. **Prandaj, MKPT konstaton se QPP përballet me mbipopullim e cila duhet të evitohet sa më shpjet që të jetë e mundur dhe nuk mund të ofrojë hapësirë akomodimi në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.**
9. Gjatë vizitës në disa qeli, MKPT ka vërejtur se të paraburgosurve u mungon hapësira për vendosjen e gjësendeve të domosdoshme personale. Përveç kësaj, në dy qeli ku akomodoheshin të paraburgosurit, tualetet nuk ishin të pajisura me dyer dhe në këtë mënyrë të paraburgosurve nuk u respektohej privatësia.<sup>5</sup> Rregulli 15 i Rregullave të Mandelës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 29 shtator 2015 përcakton se:  
*“Instalimet sanitare duhet të jenë adekuate dhe të mundësojë që secili i burgosur të përmbush nevojat fiziologjike në mënyrë dinjitoze dhe të pastër”.*
10. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kishte lagështi (me përjashtim të qelisë A3 ku vërehej pak lagështi), ndërsa dushet ishin në gjendje të mirë. Gjithashtu sallat ku ushqehen të burgosurit, ishin të pastra, kishte dritë natyrale dhe ventilim. **MKPT ka konstatuar se qelitë në përgjithësi kanë nevojë të gëlqerosen (lyhen).**
11. Sa i përket furnizimit, MKPT u njoftua se kishte mungesa të letrave higjienike, mungesa të çarçafëve; bataniqeve ku sipas drejtorisë ka kohë të gjatë që nuk janë furnizuar. Zakonisht të burgosurve u lejohet që çarçafët t'i sjellin nga familjarët. Gjatë bisedës me të burgosurit, MKPT ka pranuar ankesa për mungesë të mjeteve higjienike, ndërsa sa i përket ujit, ky problem ishte evituar. **Autoritetet duhet t'iu sigurojnë të paraburgosurve produkte higjienike që ju mundësojnë atyre pastrimin e qelive dhe të mbajnë higjienën në mënyrë adekuate.**<sup>6</sup>
12. MKPT u njoftua se të paraburgosurit mund të bëjnë dushe 2 herë në javë gjë që është në pajtim me Rregullat Evropiane të Burgjeve.<sup>7</sup> MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit sa i përket kësaj të drejte.

<sup>3</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449> (14.11.2017)

<sup>4</sup> Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>5</sup> Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 18.1.

<sup>6</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 38.2 përcakton: “Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuar iu sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme dhe ata mirëmbahen dhe pastrohen me rregull”.

<sup>7</sup> Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 19.4.

## Kuzhina

13. Gjatë vizitës në QPP, MKPT ka vizituar edhe kuzhinën ku ushqehen të burgosurit, e cila i kishte të gjitha pajisjet e nevojshme. Gjithashtu MKPT u njoftua se stafi i kuzhinës si dhe të burgosurit e punësuar në kuzhinë posedonin librezat sanitare. MKPT nuk ka hasur në ushqime me afat të skaduar. Gjatë vizitës nëpër qeli, MKPT nuk ka pranuar ankesa lidhur me kualitetin e ushqimit. Sipas personelit të kuzhinës, kuzhina përballet me mungesa të kohëpaskohshme të ushqimit dietal për kategori të caktuara të të paraburgosurve dhe të dënuarve, varësisht nga gjendja e tyre shëndetësore. **MKPT rikujton obligimin e autoriteteve kompetente për të siguruar pakot dietale për të dënuarit dhe të paraburgosurit për të cilët një gjë e tillë është e domosdoshme për shkaqe shëndetësore.**<sup>8</sup>

## Regjimi

14. Në QPP ekzistojnë këto regjime: regjimi themelorë, standard dhe të avancuar. Në QPP për momentin janë të angazhuar në punë rreth 13 të burgosur. Të paraburgosurit mund të dalin në ajrosje (shëtitje) dy herë në ditë në kohëzgjatje prej 1 ore.<sup>9</sup> Të dënuarit mund të dalin në ajrosje gjatë gjithë kohës. Sipas drejtorisë, 4 të paraburgosur janë të angazhuar në punë. Të paraburgosurit pjesën tjetër të ditës, përveç ajrosjes, e kalojnë në qelitë e tyre të cilat janë të pajisura me nga një TV aparat. Po ashtu, mungon salla dhe pajisjet për aktivitete sportive dhe fitnes. Mundësitë e të burgosurve për të lëvizur janë të vogla meqenëse hapësira në QPP këtë nuk e ofron. Po ashtu, në kuadër të QPP funksionon edhe biblioteka. Sipas vlerësimit të punëtorit social në QPP, ka kërkesa për lexim nga të paraburgosurit dhe të dënuarit. Biblioteka e QPP-së ka nevojë për libra me tituj shkencorë dhe romane.
15. Regjimi për të paraburgosurit mbetet i varfër, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë për të ofruar më shumë aktivitete për të paraburgosurit. **MKPT konsideron se sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes në paraburgim, po aq duhet të jetë i zhvilluar edhe regjimi i cili u ofrohet.**

## Kujdesi shëndetësorë

16. Gjatë vizitës në QPP, MKPT ka vizituar Ambulancën e burgut e cila si staf shëndetësor kishte: një mjek me orar të plotë, 4+1 infermier duke llogaritur punën me ndërrime për 24 orë. Një psikolog me orar të plotë dhe një psikiatër i cili është i angazhuar çdo ditë me gjysmë orari.
17. Shërbimi shëndetësor në QPP i plotëson kushtet minimale për ofrimin e kujdesit shëndetësor duke ofruar edhe mundësinë e trajtimit jashtë QPP sipas vlerësimit paraprak të mjekut. Mungesa e stomatologut kompensohet përmes dërgimit të të burgosurve për të marrë shërbime stomatologjike në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan çdo ditë premtë. Shërbimi mjekësor i QPP theksoi edhe mungesën e transportit-Autoambulancës.

<sup>8</sup> Rregullat e Mandelës, neni 22. Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 22.2. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39.1.

<sup>9</sup> Rregullat e Mandelës, neni 23. Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 27.1. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 48, publikuar në vitin 2015. Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë në së paku dy orë shëtitje.

18. Gjatë vizitës është vërejtur se hapësira e cila shfrytëzohet për kujdesin shëndetësorë është e pamjaftueshme dhe nuk i plotëson as nevojat minimale. Në shfrytëzim është një dhomë e cila përdoret për të gjitha nevojat e kujdesit parësorë nga mjeku i burgut, infermierët, nga psikologu kur ka raste për te trajtuar, si dhe është hapësirë e përhershme e qëndrimit të personelit shëndetësor.
19. Mungesa e hapësirës së veçantë për psikologun, i cili ofron shërbime psikologjike për rastet me probleme të ndryshme si: rastet me tentim të vetëvrasjes, vetëlëndimeve, probleme emocionale, me përdorues të duhanit, alkoolit, drogave, e vështirëson punën e psikologut si dhe nuk ofron rehati për të burgosurit që kanë nevojë për shërbime psikologjike.
20. Është evidentuar dhe një hapësirë e cila shërben si depo për barëra aktualisht te përdorshme si dhe akomodimin e pakove me barërave me afate të skaduar. Po ashtu është përmendur edhe një hapësirë e vogël e cila tashmë është e mbushur me pako të shumta me barëra me afat të skaduar. Shërbimi mjekësor ka parashtruar kërkesë për largimin dhe asgjësimin e tyre por ende nuk ka marrë përgjigje. Kurse pajisjet e nevojshme medicinale për dhënien e shërbimeve shëndetësore janë në pajtim me standardet e MSH. Gjatë bisedës me Udhëheqësin e NjShB në QPP u tha se stafi shëndetësor ka bërë vizitat sistematike të personelit shëndetësorë.

### **Regjistrat**

21. Spitali i burgut mban regjistrat si në vijim: dosja shëndetësore e mjekut, regjistri i infermierit me ndërrime, terapisë, ankesave apo kërkesës për vizitë të radhës te mjeku, dërgimit të pacientit për trajtim jashtë ambulancës së burgut, vetëlëndimit, lëndimet trupore, abuzimet seksuale, grevës së urisë, tentim vetëvrasje, i vetmisë, vdekja në burg.
22. MKPT konsideron se duhet të mbahet evidencë e dosjes shëndetësore në raste kur pacienti shkon për trajtim jashtë ambulancës së burgut (e cila pacientit i jepet me vete kur dërgohet jashtë QPP-së për shërbime tjera mjekësore) dhe po ashtu të mbahet evidencë me rastin e kthimit të pacientit në QPP. Kjo mënyrë e evidentimit mundëson ruajtjen e dosjes shëndetësore në tërësi dhe është me rëndësi për të burgosurin edhe pasi të del nga burgu. Po ashtu është e rëndësishme që në raste të vdekjes në burg të ketë dokumentacion i cili do të mbetet si dëshmi nga organet relevante për vdekjen e pacientit.

### **Kontrolli mjekësor**

23. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.
24. QPP e njoftoi ekipin e MKPT-së, se të sapo pranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në qendër. Këto kontrole nënkuptojnë një kontroll të përgjithshme dhe gjatë së cilës i burgosuri pyetet nëse ka ndonjë sëmundje e cila, nëse deklarohet, regjistrohet në dosjen e tij mjekësore.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

25. MKPT është interesuar nëse personeli mjekësor të dënuarve dhe të paraburgosurve në QPP u ofron shërbimet mjekësore në prezencë të zyrtarëve korrektues. Gjatë vizitës

MKPT konstatoi se shërbimet mjekësore në ambulancën e burgut jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues si dhe zyrtarët korrektues nuk kanë qasje në dosjet shëndetësore të të burgosurve. **MKPT përkrahë një qëndrim dhe praktikë të tillë të mos prezencës së zyrtarëve të sigurisë gjatë dhënies së shërbimeve mjekësore.**<sup>10</sup>

### Trajnimet për shërbimin mjekësor

26. Sipas njoftimit nga DSHB, personelit mjekësor gjatë vitit ka pasur disa trajnime relevante të cilat ndërlidhen me punën e tyre.

### Çështje të tjera

#### Personeli i QPP

27. Bazuar në informatën e marrë nga drejtoria, personeli i QPP përbëhet nga 17 personel civil dhe 82 zyrtar korrektues. MKPT gjatë vizitës ka vërejtur se kushtet e punës së personelit të SHKK nuk janë në nivel të kënaqshëm pasi që ka mungesë të hapësirave të duhura dhe inventarit përcjellës. QPP po ashtu përballet me mungesë të personelit të mjaftueshëm.
28. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua se për momentin qendra ballafaqohet me mungesë të materialeve të ndryshme për zyre, inventar, kompjuterë, printerë, tonerë dhe disa nga këto pajisje janë të vjetërsuara. **MKPT konstaton se SHKK duhet të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që QPP të furnizohet me të gjitha materialet e nevojshme për punë.**

#### Masat disiplinore

29. Sipas legjislacionit në fuqi dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>11</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, Avokatin e Popullit dhe misionet diplomatike. MKPT konstatoi se QPP mban regjistër për masat e shqiptuara disiplinore ku shënohen të dhëna lidhur masën e shqiptuar, arsyen, kohën e shqiptimit dhe mbarimit.
30. MKPT u njoftua nga drejtoria e QPP se vetëlëndimi në këtë qendër nuk konsiderohet shkelje disiplinore. **MKPT përshëndet një qëndrim të tillë pasi që vetëlëndimi nuk përfshihet në grupin e shkelje disiplinore të parapara në nenin 102 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.**
31. MKPT u njoftua se shërbimi mjekësor nuk merr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të dënuarit për të përballuar masën disiplinore të vetmisë. **MKPT konsideron se personeli mjekësorë e ka të qartë rolin e tij në këtë aspekt.** Pjesëmarrja e mjekut në vendimmarrje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo dënuar, do të minonte raportin mjek-pacient, përveç nëse kjo masë ndërmerret për arsye mjekësore.<sup>12</sup>

<sup>10</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për Kosovën pas vizitës në Kosovë në vitin 2015, pati vërejtje lidhur me ofrimin e shërbimeve mjekësore në prezencë të zyrtarëve korrektues dhe rekomandoi ndërprerjen e praktikave të tilla.

<sup>11</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>12</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpritet praktika e kërkesës nga mjeku vërtetimi se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje për ta përballuar masën dhe të ndryshohet legjislacioni në fuqi në pajtim me këtë rekomandim.

32. Por, MKPT shpreh shqetësimin për faktin se legjislacioni në fuqi<sup>13</sup> parasheh që para se i burgosuri të vendoset në vetmi drejtori i shërbimit të institucionit korrektues të kërkojë me shkrim mendimin e mjekut i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe psikike. **MKPT kërkon nga autoritetet relevante që dispozitat në fuqi të këtyre akteve të ndryshohen në pajtim me rekomandimin e KPT në raportin për Kosovën, në pajtim me raportin e përgjithshëm të 21-të të KPT dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2006) 2 për Rishikimin e Rregullave Evropiane të Burgjeve, me të cilën kërkohej mendimi me shkrim se i burgosuri mund t'i nënshtrohet kësaj mase, u largua.**

### **Kontakti me botën e jashtme**

33. Legjislacioni në fuqi<sup>14</sup>, në rastin e personave të dënuar përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj e cila zgjatë minimum një orë, si dhe në vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre së paku një herë në 3 muaj me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.
34. Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>15</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta). **MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me këtë të drejtë.**
35. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. **MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë lidhur me këtë të drejtë nga të paraburgosurit.**
36. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.
37. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilit e ka ai.<sup>16</sup> Gjatë vizitës, MKPT i ka intervistuar shtetasin turk U.T, i cili nuk pati ankesa lidhur me gëzimin e kësaj të drejte dhe të drejtave të tjera të personave të paraburgosur. **MKPT nuk ka pranuar ankesa lidhur me të drejtën për kontakte me botën e jashtme as nga të dënuarit dhe as nga të paraburgosurit.**

### **Çështje të ndërlidhura me sigurinë**

<sup>13</sup> Neni 107 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe neni 76 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

<sup>14</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

<sup>15</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

<sup>16</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33 paragrafi 1.

38. MKPT u njoftua nga drejtoria se të gjitha pavijonet dhe objektet e QPP janë të pajisura me kamera të sigurisë të cilat, sipas KPT, përbëjnë një nga garancitë për mbrojtje nga keqtrajtimi.<sup>17</sup>
39. **Po ashtu, MKPT këshillon autoritetet relevante që sigurojnë mundësi teknike që të dhënat e regjistruara nga kamerat e sigurisë të ruhen një kohë më të gjatë pasi që në këtë mënyrë mund të hetohen në mënyrë më efektive pohimet eventuale për keqtrajtim apo përdorim të tepruar të forcës fizike.**

#### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

40. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
41. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti më të lartë, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministri i Drejtësisë.<sup>18</sup>
42. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QPP janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
43. Drejtoria e QPP e njoftoi MKPT se ankesat e pranuar i shqyrton në kohë sa më të shkurtër, madje edhe brenda 24 orëve. Të dënuarit dhe të paraburgosurit e njoftuan MKPT se drejtoria e QPP zakonisht shumë shpejt i shqyrton ankesat e tyre dhe u dërgon përgjigje me shkrim.
44. **MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me çështjen e parashtrimit të ankesave apo vonesa për të shqyrtuar ankesat e tyre brenda afatit ligjor.**

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

#### **Ministrisë së Drejtësisë:**

- **Ministria e Drejtësisë të njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me planifikimet për ndërtimin e Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren.**

<sup>17</sup> KPT, raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.

<sup>18</sup> Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.

- Të krijohen kushte adekuate të punës për personelin mjekësor.
- Numri i të paraburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejtë që të jetë e mundur.
- Të ndërmerren masat e duhura në mënyrë që të paraburgosurve t'u respektohet privatësia (shih paragrafin 9 të këtij raporti).
- Të gëlqerosen qelitë sipas nevojës (shih paragrafin 10).
- Të përmirësohen kushtet e punës së zyrtarëve korrektues.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit